



REPUBLIKA EKOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/149

Datë 15.05.2025

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17, nenit 24, nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (c), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/15, qershor 2008) nenit 9 paragrafi 1 pika 1,2 të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxheti e Republikës së Kosovës për vitin 2025 të Ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/03 qershor 2008, neni 27 të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/03 qershor 2008), bazuar në nenin 53 par. 53.3, të LPPA-së, dhe në bazë të Statutit të Komunës së Malishevës, nr.02/441, datë: 14.09.2023

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 15.05.2025 merr këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE NGA VITI 2024 NË VITIN FISKAL 2025

1. Miratohet kërkesa nr.04/226 datë: 11.04.2025, e drejtorisë për buxhet dhe financa, për bartjen e mjeteve vetanake (THV) nga viti fiskal 2024 në vitin fiskal 2025 dhe destinimin e tyre sipas përshkrimit të poshtëshënuar;
2. Mjetet vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2024, nga fondi burimor 21 dhe 22 i të hyrave vetanake kapin shumën prej 338,743.92€, shumë e cila bartet në vitin fiskal 2025.
3. Kuvendi i Komunës vendos që shumën prej 338,743.92€, të destinojë sipas tabelës në vijim:

Nën-programi	Kodi i nënprogramit	Kodi funksional	Fondi burimor	Kategoria ekonomike	Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Shuma për bartje në 2025
Planifikimi mjedisor dhe inspeksioni	66570	0620	22	30	51787	Rregullimi i qendrës-sheshit të qytetit të Malishevës	200,000.00 €
Planifikimi mjedisor dhe inspeksioni	66570	0620	22	30	53427	Asfaltimi i rrugëve në fshatrat; Ngucat, Kërvasari, Llapqevë, Mirushë, Turjak, Astrazup, Rud, Panorc, Pagarush, Terpeze poshtme, Shkarashnik, Lumishtë, Banjë, Gajrak, Gurishtë, Carralluk, Gurbardh	85,743.92 €
Arsimi fillor i mesëm i ulët	93360	0912	22	30	54583	Renovimi i objekteve shkollore në fsh; Bardh, Drenoc, Mleqan, Bubavec, Ngucat, Astrozup, Senik, Vermic, Carralluk, Bellanic, Temeqin, Gullubovc, Kijev, Stapanic.	50,000.00 €
Buxheti	17513	0112	22	13	-	Mallra dhe shërbime	3,000.00 €
						Totali për bartje	338,743.92€

Arsyetim;

Kërkesen për bartjen e meteve në Projektin Rregullimi i sheshit të qytetit ka një kosto të madhe dhe me qëllim që ti inkasojmë punimet sepse gati po thuhet se jemi në përfundim të projektit kemi paraparë shumën prej 200,000.00€ që ti orientojmë të ky projekt.

Kërkesen për bartjen e meteve në Asfaltim i rrugëve në fshatrat; Ngucat, Kërvasari, Llapqevë, Mirushë, Turjak, Astrazup, Rud, Panorc, Pagarush, terpeze poshtme, Shkarashnik, Lumishtë, Banjë, Gajrak, Gurishtë, Carralluk, Gurbardh; Tek ky projekt kemi paraparë këtë shumë për arsye se plani dinamik i punës përfundon këtë vitë.

Kërkesen për bartjen e meteve në Renovimi i objekteve shkollore në fsh; Bardh, drenoc, Mleqan, Bubavec, Ngucat, Astrozup, Senik, Vermic, Carralluk, Bellanic, Temeqin, Gullubovc, Kijev, Stapanic.

Tek ky projekt kemi paraparë këtë shumë për arsye se kemi obligime ndaj operatorit. Ndërsa të M+SH kemi një shumë prej 3,000.00.€ për arsye të një kthimi të pagesës së një qytetari për pagesën e një leje nderimore.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunes, përmes Drejtoris për Buxhet dhe Financa.

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81. Të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës

